

Rektorja e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Prof. Dr. Elvira Fetahu, mori pjesë në Ceremoninë Solemne të 55-vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës

Rektorja e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Prof. Dr. Elvira Fetahu, mori pjesë në Ceremoninë Solemne të 55-vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës, një ngjarje e rëndësishme që mbledhi personalitete të shquara të botës akademike, shkencore dhe politike.

Universiteti i Elbasanit është pjesë aktive e rrjetit të institucioneve që kontribuojnë në zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në hapësirën shqiptare dhe më gjerë.



